

Çfarë është prodhuar nga Projekti NETCET?

13 partnerë nga 5 vende të ndryshme në brigjet e Detit Adriatik kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin, duke krijuar një skuadër kompakte me të njëjtin qëllim: **zhvillimi i strategjive të përbashkëta për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Adriatik.**

Hap pas hapi, një aktivitet i projektit ka nxitur aktivitetin tjetër: **monitorimet ajrore me avion, me anije në det dhe me satelit** kanë siguruar të dhëna shumë të rëndësishme mbi shpërndarjen dhe dendësinë e popullatave të këtyre llojeve të mbrojtura; krijimi i **datbazave** për grumbullimin e të dhënave mbi kafshët e dala në breg përgjatë Adriatikut është shndërruar në një platformë për shkëmbime pune mes ekspertëve të trajnuar në kuadër të projektit. Këto aktivitete kanë çuar në propozimin e ngritjes së një **Task Force për Emergjencat në Adriatik**, e aftë për të ndërhyrë në rastet e daljeve masive të kafshëve në brigje.

NETCET gjithashtu ka mbështetur zhvillimin e **qendrave të emergjencës dhe rehabilitimit** të breshkave detare dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të tyre. Projekti ka rritur ndërgjegjen publike për ruajtjen e cetaceve dhe breshkave detare përmes **aktiviteteve ndërgjegjësuere** me peshkatarë, pronarët e anijeve, studentët dhe grupe të ndryshme të interesuar.

Në sajë të Programit IPA Adriatic CBC është bërë i mundur financimi i këtyre aktiviteteve dhe sigurimi i një baze të mirë të dhënash për projekte të ardhshme, të cilët do të synojnë mbrojtjen e biodiversitetit të Detit Adriatik.



Gjatë zbatimit të Projektit NETCET partnerët kanë organizuar takime konsultative në vendet e tyre (Itali, Slloveni, Kroaci, Mali i Zi dhe Shqipëri) me ministritë dhe të gjithë aktorët e lidhur me cetacete dhe breshkat detare, me qëllim që:

- të përcaktohen elementët kryesorë për përmirësimin e PKV-ve ekzistuese;
- të zhvillohen PKV të reja dhe të miratohen nga ministritë përkatëse;
- të nxitet zbatimi i PKV-ve ekzistuese.

PLANET KOMBËTARE TË VEPRIMIT (PKV) PËR MBROJTJEN E BRESHKAVE DETARE DHE CETACEVE NË VENDET E NETCET

Aktualisht, menaxhimi i mbrojtjes së cetaceve dhe breshkave detare në Detin Adriatik bëhet nga institucionet qeveritare, si dhe organizatat jo-fitimprurëse. Megjithatë, nuk ka ndonjë institucion, ose organizatë ndërkombëtare përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të përbashkëta për mbrojtjen e këtyre llojeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të sigurohet që objektivat dhe veprimet e propozuara të përfshihen në strategji dhe dokumente të tjera për Detin Adriatik.

Për më tepër, **këto Strategji** të përgatitura, ose të rishikuara në kuadër të Projektit NETCET, duhet të përdoren si udhëzuese për zhvillimin e Planeve Kombëtare të Veprimit në secilin vend të Adriatikut.

ZBATIMI I STRATEGJIVE

Është përgatitur një plan veprimi për arritjen e secilit objektivi. Për shembull, për të reduktuar ndikimin e kërcënimeve, një nga synimet është "zvogëlimi i ngordhjeve dhe plagosjeve të shkatëruara nga njeriu". Mëqenëse dëmet e shkatëruara nga peshkimi, si zëniet e paqëllimshme, janë përcaktuar si kërcënim kryesor, janë propozuar shumë veprime prioritare për mbrojtjen prej tyre. **Strategji të përbashkëta për Mbrojtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare, në formën e dy broshurave, gjenden online në adresën e mëposhtme:** (www.netcet.eu/dissemination).

PËRCAKTIMI I VEPRIMEVE DHE PRIORITETEVE

PARTNERËT

- Bashkia e Venecias (IT) - kordinator
- Universiteti i Padovës, Departamenti i Biomjeksisë Krahasuese dhe Shkencës së Ushqimit (IT)
- Bashkia e Peskarës (IT)
- Fondazioni Cetacea (IT)
- Instituti Kombëtar Italian për Kërkimin dhe Mbrojtjen e Mjedisit (IT)
- Instituti Shtetëror për Mbrojtjen e Natyrës (HR)
- Instituti "Blue World" për Studimin dhe Mbrojtjen e Detit (HR)
- Shoqata e Herpetofaunës Shqiptare (AL)
- Shoqata e Mbrojtjes së Gjallesave Ujore të Shqipërisë (AL)
- Instituti i Biologjisë Detare (MNE)
- Universiteti Primorska, Qendra e Shkencës dhe Kërkimit (SI)
- WWF Itali (IT)
- Qendra e Edukimit Detar Pula (HR)

INSTITUCIONE TË ASOCIUAR

- Instituti për Mbrojtjen e Natyrës i Republikës së Sllovenisë (SI)
- Rajoni i Venetos – Departamenti i Pyjeve dhe Parqeve (IT)
- Rajoni Emilia Romanja – Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e Mjedisit, Tokës dhe Bregdetit (IT)
- Rajoni i Markes – Departamenti i Ekologjisë dhe Mbrojtjes së Kafshëve (IT)

KONTAKT

City of Venice
European Policies Division
european.policies@comune.venezia.it
partners@netcet.eu
www.facebook.com/NETCETproject
www.netcet.eu

netcet

Rrjeti për Mbrojtjen e Cetaceve dhe Breshkave Detare në Adriatik

Kjo broshurë është prodhuar me mbështetjen financiare të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Adriatik. Përmbajtja e kësaj broshure është nën përgjegjësinë e Bashkisë së Venecias dhe në asnjë rrethanë nuk pasqyron pozicionin e autoriteteve të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Adriatik.

REZULTATET



The project is co-funded by the European Union, Instrument for Pre-Accession Assistance.

www.nachgroup.it

Këto objektivat janë të lidhura me strategji globale dhe rajonale, si ato të Aichi target 2011-2020, Strategjia e BE-së për biodiversitetin 2010-2020, Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jun, si dhe Strategjia e ACCOBAMS për cetacete 2014-2025.

- 1 Përmirësimi i njohurive mbi cetacete dhe breshkat
- 2 Reduktimi i ndikimit të kërcënimeve, veçanërisht nga peshkimi
- 3 Rritja e bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm
- 4 Ngritja e një kuadri ligjor të përbashkët për mbrojtjen e tyre në Detin Adriatik
- 5 Sigurimi i mbrojtjes efektive të habitateve të rëndësishme të cetaceve dhe kuptimi i efikasitetit të zonave të mbrojtura për ruajtjen e breshkave detare në Detin Adriatik
- 6 Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore për mbrojtjen e këtyre katshëve në Detin Adriatik
- 7 Ndërgjegjësimi i publikut
- 8 Sigurimi i fondeve të nevojshme

OBJEKTIVAT

Analiza e gjendjes aktuale të njohurive dhe kapaciteteve ka mundësuar përcaktimin e një të ardhme ideale për cetacete dhe breshkat detare në Detin Adriatik: për secilin grup janë përcaktuar 8 objektiva.

Aktiviteti ka filluar me përgatitjen e një pasqyre të përgjithshme të shkallës së njohjes mbi cetacete dhe breshkat detare në Detin Adriatik: përhapja, dendësia e popullatave, kërcënimet. Më tej, është grumbulluar informacion mbi kapacitetet njerëzore ekzistuese: legjislativi kombëtar, kuadri institucional, mekanizmat ekzistues të mbrojtjes dhe sistemi i zbatimit të tyre janë rishikuar në të pesë vendet e Adriatikut.

Zhvillimi i strategjive të përbashkëta për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Detin Adriatik

Partnerët e NETCET kanë përcaktuar nevojat e ardhshme për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare në Detin Adriatik, duke zhvilluar Strategji të posaçme për dekadën e ardhshme (2016 – 2025). Këto dokumente synojnë që njohuritë ekzistuese të shndërrohen në masa konkrete mbrojtëse, me qëllim që të arrihet vizioni i përbashkë:



Zhvillimet mbi ruajtjen në Detin Adriatik

Mjetet e emergjencës dhe të trajtimit

Një nga iniciativat e para të NETCET ishte krijimi i një rrjeti shkencor me ekspertë të fushave të ndryshme në basinin e Adriatikut, me qëllim këmbimin e njohurive dhe përvojave, si dhe zhvillimin e **databazave të përbashkëta për raportimin e daljeve në breg**. Ky rrjet ndihmon studiuesit për vëzhgimin e rritjes së mundshme të vdekjeve të kafshëve në Detin Adriatik dhe për ndjekjen e protokolleve dhe strategjive të përbashkëta për t'u përballur me emergjencat e ardhshme.

NETCET gjithashtu ka ngritur një **Task Forcë për Emergjencat në Adriatik**. Kjo përbëhet nga një grup ekspertësh biologë dhe veterinerë, të shkencave të lidhura me cetacët dhe breshkat detare, si sjellja, fiziologjia, shërimi dhe trajtimi, të kualifikuar për ndërhyrje në rastet e aksidenteve mjedisore, rasteve të ngordhjeve masive, ose daljeve masive në breg. Ato veprojnë si ekupe ekspertësh, në mbështetje të autoriteteve kombëtare. Aksidenti i parë gjatë periudhës së zbatimit të NETCET ndodhi në Shtator 2014 në Vasto, Itali, ku shtatë kashalotë dolën në breg. Mbi tetëdhjetë anëtarë të task forcës punuan së bashku për shpëtimin e këtyre kafshëve.

133 veterinerë kanë përfutur nga **programet e trainimeve mbi teknikat veterinarë** dhe menaxhimin e daljeve në breg për cetacët dhe breshkat detare.

Janë prodhuar dhe shpërndarë **protokolle standarte** për ekzaminime post-mortem dhe fizike për cetacët dhe breshkat detare.

Janë prodhuar **tekste librash reference mbi teknikat veterinarë** për specialistë që punojnë për cetacët dhe breshkat detare dhe u janë shpërndarë grupeve të ndryshme të interesit.

Databazat e breshkave detare dhe cetaceve



www.adriaticseaturtles.eu



www.marinemammals.eu/database_spiaggiamenti

Monitorimi i Detit Adriatik

Rezultatet nga aktivitetet e monitorimit në kuadër të NETCET tregojnë se **Deti Adriatik është më i rëndësishëm për cetacët dhe breshkat detare se nga sa mendohej më përpara**.

Vrojtimi ajror (mbi 14,000 km në 100 orë fluturime) ka siguruar informacione mbi përdorimin e Detit Adriatik nga këto lloje dhe ka konfirmuar se Adriatiku Verior ka rëndësi të veçantë për breshkat detare. Kjo është konfirmuar nga **gjurmimet satelitore të 20 juvenilëve të breshkës së zakonshme të detit (JLT) dhe 3 juvenilëve të breshkës së gjelbër (GT)**, të cilat provuan se **JLT qëndron në Adriatik** pavarësisht ndryshimeve stinore, duke u varur ndjeshëm nga zonat e ushqimit në Adriatikon Verior, ndërsa **GT zhvendoset drejt ujrave më të ngrohtë në Adriatikon Jugor gjatë dimrit**.

Lëvizjet e breshkave të NETCET mund të ndiqen online në adresën e mëposhtme: www.seaturtle.org/tracking/?project_id=1021

Vrojtimi ajror tregoi gjithashtu për një **diversitet të lartë të cetaceve** në rajon, me një numër të madh të delfinëve me vija dhe prani të balenës me sqep të Kuvierit në Jug të Detit Adriatik. Popullatat e delfinit hundëshishe janë monitoruar përmes **studimeve me fotografime** të vazhdueshme (mbi 500 orë vajtme me skaf) në të gjithë vendet e Adriatikut. Analizat tregojnë që **secila popullatë është unike, me këmbime të vogla me njëra-tjetrën**.

Janë ekzaminuar kafshët e dala në breg dhe janë analizuar shkaqet e ngordhjeve të tyre, si në rastet e daljeve individuale, ashtu edhe ato masive.

Ndiqini "NETCET" breshkat detare



Fushatat ndërgjegjësuere përgjatë Adriatikut

100 aktivitete publike për lëshimin e breshkave në det, me pjesëmarrjen e mbi 10,000 njerëzve.

shpërndarje informacioni nga mass-media për rreth **2 milion banorë** mbi mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare.

ndërgjegjësim i **mbi 700 peshkatarëve** për ndikimet mjedisore që ato shkaktojnë ndaj breshkave detare, si dhe mbi procedurat që duhen ndjekur për shpëtimin e kafshëve të kapura aksidentalisht në mjetet e tyre të peshkimit.

Rrjeti i qyteteve NETCET

Ky është një rrjet i qyteteve përgjatë bregut të Adriatikut, me qëllim rritjen e ndërgjegjes për mbrojtjen e cetaceve dhe breshkave detare. Për më shumë: www.netcet.eu/city-network

Qendra e emergjencës

Ndihma e parë për breshkat detare të plagosura (maksimumi i qëndrimit: 48 orë përpara transferimit në një qendër reabilitimi)

Qendra e reabilitimit

Asistencë për breshkat detare në "fazën e hospitalizimit ose konvaleshencës"

VENECIA - ITALI

Qendra e emergjencës së breshkave përbëhet nga 3 vaska dhe një laborator i pajisur me mjetet e ndihmës së shpejtë veterinarë. Gjithashtu është ngritur një zyrë për grumbullimin e të dhënave mbi breshkat detare.



RIÇONE - ITALI

NUMANA - ITALI

Është përshtatur një zonë e mbrojtur në det për monitorimin e shërimit të breshkave detare përpara lëshimit të tyre.

PESKARA - ITALI

Është ngritur qendra e reabilitimit të breshkave, me një ambient të konvaleshencës dhe të izolimit, e pajisur me 15 vaska. Qendra ka edhe një ambient për aktivitete edukative dhe një tjetër për konferenca dhe trainime për profesionistët.

Qendra të ngritura në sajë të Projektit NETCET:

Qendra emergjence

Qendra reabilitimi

- Qendra emergjence ekzistuese, ose ● Qendra reabilitimi të përmirësuar në sajë të Projektit NETCET:
- 1 Ishulli Brač (Kroaci) 7 Dubrovnik (Kroaci)
- 2 Rijeka (Kroaci) 8 Korçula Island (Kroaci)
- 3 Zadar (Kroaci) 9 Lošinj (Kroaci)
- 4 Ishulli Pag (Kroaci) 10 Krk (Kroaci)
- 5 Šibenik (Kroaci) 11 Pula (Kroaci)
- 6 Split (Kroaci) 12 Riçone (Itali)

dhe dy qendra në Zagreb (Kroaci): Instituti Kroat i Veterinarisë (IKV) dhe Universiteti i Mjeksisë Veterinarë (UMV)

Rrjeti i qyteteve NETCET



PULA - KROACI

LOSHINJ - KROACI

Qendra e reabilitimit të breshkave e Institutit Blue World ndodhet në mes të kompleksit turistik "Sunny Bay" në Mali Loshinj dhe ka kapacitet për mbajtjen e 4 breshkave të plagosura, për një kohë të shkurtër reabilitimi.



PATOK - SHQIPËRI

Qendra përbëhet nga 2 dhoma: një laborator i pajisur me mjetet e ndihmës së shpejtë veterinarë dhe 2 vaska, si dhe një sallë konferencash me kapacitet 50 vende për aktivitete ndërgjegjësuere.

